

KARTELË INFORMATIVE

AL039006

1. Emri i shërbimit	Vërtetimi i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit)			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Ky dokument lëshohet për të vërtetuar nëse një person ka qenë i dënuar ose jo. Ky vërtetim mund të përdoret për: Kërkesë nga punëmarrësi, procedurë e plotësimit të dosjes së punës; - Punësim në Administratën Publike; - Në rastin e të dënuarve, si atyre aktualë ashtu dhe politikë; • Paraqitja e këtij dokumenti në autoritetet e huaja: ambasadë, aplikim për nënshtetësi të huaj dhe në rast fillimi procedimi penal nga shteti i huaj.			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Pajisjen me vërtetimin e gjendjes gjyqësore të shtetasve (nëse kanë qenë të dënuar më parë, si dhe statusin aktual).			
4. A jam përfitues?	Qytetarët shqiptarë dhe ata të huaj që janë/kanë qenë rezident në Shqipëri.			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Dokumenti lëshohet nga:	Dorëzohet në sportel nga aplikanti?
	1	Kartë Identiteti ose Pasaportë për tu regjistruar në portal	Zyrat e Gjendjes Civile	Jo
	2	Në rastin kur aplikimi për vërtetimin e periudhës së burgut nuk bëhet nga vetë shtetasi i cili ka kryer dënimin, atëherë ngarkohet një dokument që vërteton lidhjen familjare me shtetasin për të cilin kërkohet ky vërtetim, psh certifikatë familjare	Zyrat e Gjendjes Civile	Po
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Online në portalin e- Albania, Sportelet e Postës Shqiptare	Kudo në vend, Në çdo sportel të Postës Shqiptare	Online në portalin e- Albania.al Sportelet e Postës Shqiptare	Online: 24 orë E hënë - e premte, ora 08:00 - 20:00 E shtunë, ora 08:00 - 14:00
7. A është ky shërbim online?	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë	Tarifa shtesë	Tarifa Online	Mënyra e pagesës
	Online: pa pagesë; 200 lekë taksë pulle në rast se aplikohet në sportel	220 lekë shërbimi postar		Në postë (tek "Posta Shqiptare")
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	6 ditë nga momenti i hyrjes në Sektorin e Gjendjes Gjyqësore			
10. Çfarë përfitoj?	Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore (Dëshmia e Penaltetit)			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	3 muaj			
12. Ku e marr?	Në sportele	Me postë	E-albania	Me e-mail
13. Cili është institucioni përgjegjës?	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (DPB)			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontaktto në:		Orari	
	E- albania: e-albania.al ADISA web: www.adisa.gov.al ADISA email: Informacion@adisa.gov.al DPB web: http://www.dpbsh.gov.al/newweb/ Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: 0800 0118		Qendra e Informimit mbi Shërbimet Publike: E hënë - e premte, ora 08:00 - 19:00	
15. Nëse kam ankesë, si të	Në sportele	Me postë	Web-i i Institucionit	Me e-mail

veproj?	Në platformën "Shqipëria që duam" Link: www.shqiperiaqeduam.al 
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	• Ligji Nr. 9614, datë 21.09.2006 Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore" • VKM Nr. 824, datë 06.12.2006 Për miratimin e institucioneve të autorizuar për verifikimin, në mënyrë elektronike, të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit" • Rregullore e brendshme të miratuar nga Ministria e Drejtësisë • Rregullore e brendshme të funksionimit të sektorit të gjendjes gjyqësore